



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 177/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Vlastimir Dimić kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik, për shkak të vendosjes se posterave në vendet publike, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 18.06.2012, mori këtë:

### VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV), dega në Kaçanik, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 2000 (dymijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 16.06.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se me 15 qershor 2012 rreth orës 17:00 në fshatin Kaçanik i vjetër, militantë të PDK-së kanë vendosur banerë në objektin e shkollës fillore “Qamil Ilazi” të kandidatit të tyre për kryetar komune të Kaçanikut Besim Ilazi.

Parashtruesi i ankesës thekson se është bëre shkelje e Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2009, dhe Ligji për zgjedhjet e përgjithshme. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografin si dëshmi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 16.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 18.06.2012, në ora 12:00.

Sipas afatit të caktuar PZAP-i, nuk mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

## Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit të PDK-së për kryetar komune të Kaçanikut Besim Ilazi është i vendosur në objekt publik gjegjësisht në objektin e shkollës filllore "Qamil Ilazi" në Kaçanik të Vjetër, gjë që e bënë përgjegjëse subjektin politik PDK, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me nenin 3.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2009 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së te cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që ndalon vendojen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë godinave dhe objekteve publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Andaj duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës PZAP-i vlerëson se subjekti politik PDK në këtë rast ka thyer kodin e mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, shkelje për të cilën parashihet shqiptimi i dënimit me gjobë, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika (c) si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 177/2012 më datën 18.06.2012.

